



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Terra Mineralna Gnojiva d.o.o nga shoqëritë Yildirim Balkan Fertilizer d.d. dhe Yildirim International Fertilizer Investments B.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 710 Prot., i AK, datë 08.12.2022 “Depozitimi i njoftimit në lidhje me transaksionin midis Yildirim Balkan Fertilizer d.d., Yildirim International Fertilizer Investments B.V., Ina Industrija Naftë d.d. dhe Prvo Plinarsko Društvo d.o.o.”.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen dhe shitjen e aksioneve të biznesit”, nënshkruar më datë 10 nëntor 2022, palët janë:

**Blerësi 1: Yildirim Balkan Fertilizer d.d.**, është një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me veprimtari të menaxhimit të shoqërive mbajtëse, biznesin e pasurive të paluajtshme, blerje dhe shitje të mallrave, përfaqësimi i kompanive të huaja, kontabilitet, etj, me aksioner të vetëm shoqërinë Yildirim International Fertilizer Investments B.V.

**Blerësi 2: Yildirim International Fertilizer Investments B.V.**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me aktivitet: mbajtje financiare.

Blerësit janë pjesë e grupit Yildirim, i cili aktualisht operon në 9 industri: metalurgjikë dhe minierë, qymyr dhe coke, energji, plehra kimike ose fertilizues dhe kimikate, menaxhim porti, transport dhe logjistikë, ndërtim dhe pasuri të paluajtshme, investime financiare dhe tregti ndërkombëtare.

Grupi Yildirim, është aktualisht aktiv në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë Albchrome Holding SHPK.

**Shitësi 1: Ina-Industrija Naftë d.d.**, është një shoqëri, aksionet e së cilës janë të listuar në tregun e rregulluar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt veprimtarie; nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror, prodhime kimike, mineral, plehëruesve dhe lidhjeve me azotin, furnizimi me avull dhe ujë të nxehtë, këshilla dhe blerje të software, etj.

**Shitësi 2: Prvo Plinarsko Društvo d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt aktiviteti; projektim, ndërtimi, prodhimi i rrjetit të gazit, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë termike, etj.

**Target:**

**Terra Mineralna Gnojiva d.o.o.**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me ortak shoqërinë Ina-Industrija Naftë d.d., dhe shoqërinë Prvo

Plinarsko Drustvo d.o.o. dhe me objekt biznesi: blerja dhe shitja e mallrave, përfaqësimi i kompanive të huaja, ndërmjetësimi tregtar në tregjet e brendshme dhe të jashtme, konsulencë në lidhje me biznesin dhe menaxhimin, aktivitet e menaxhimit të shoqërisë mbajtëse, etj.

Terra Mineralna Gnojiva d.o.o., duke qenë një shoqëri holding , nuk është aktive në asnjë treg përkatës dhe nuk gjeneron asnjë të ardhur në Shqipëri. Terra Mineralna Gnojiva d.o.o., është aksioneri kryesor tek shoqëria Petrokemija, d.d.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**